



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr.268, Datë 11.09.2023**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T” SH.P.K. NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI  
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 1950 KW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.09.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/18 prot., datë 08.09.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1950 kW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.07.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 214, datë 03.08.2023, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye se në këtë aplikim nuk ishte depozituar asnjë dokument, ku Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “2T” sh.p.k. dhe “2B 1979” sh.p.k., i cili mban dhe miratimin e MIE-s për ndërtimin e centralit fotovoltaik, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, t’i ketë njohur të drejtën shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. për të operuar këtë central.
- ERE, ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 214/2023 me shkresën nr. 1964/6 prot., datë 08.08.2023 dhe i ka dhënë udhëzimet përkatëse në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964/7 prot., datë 10.08.2023, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 7 të Rregullores, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 251, datë 16.08.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.08.2023 dhe 18.08.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.08.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1964/12 prot., datë 29.08.2023, nr. 1964/14, datë 07.09.2023 dhe nr. 1964/16 prot., datë 08.09.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues për këtë aplikim.
- Në vijim të depozitimit dhe verifikimit në ERE të Deklaratës Noteriale, nr. 3723 rep., nr. 1949 kol., datë 10.08.2023, nëpërmjet së cilës përkatësisht shoqëria “2T” sh.p.k., shoqëria “2 B 1979” sh.p.k. dhe shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., deklarojnë se: *Sipas Miratimit për Ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2MW, dhe veprave ndihmëse, në Zonën Grykë, Bashkia Fier, Qarku Fier" nr. 7234/2 datë 22.11.2022, Shoqëria "Joint Venture 2B 1979 dhe 2 T shpk " do të kryejë operimin e impiantit gjatë të gjithë periudhës së afatit të licencës, është depozituar nga shoqëria dhe shkresa e datës 28.08.2023, me anë të së cilës është vënë në dijeni MIE se Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “2T” sh.p.k. dhe “2B 1979” sh.p.k., në referencë të kontratës së nënshkruar me MIE-n me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, kanë krijuar shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik.*
- Duke qenë se miratimi për pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes dhe VNM-së Paraprake janë dhënë për kapacitetin 1950 kW, ndërkohë që në Kontratën me MIE-n nr. 3110 rep., nr. 1429 kol., datë 19.05.2023, është parashikuar që kapaciteti i centralit është 2 MW, aplikuesi ka sqaruar se: *“Fuqia impiantit për arsye teknike është parashikuar të jetë 1950 kW ose 1.95 MW. Kjo fuqi nuk tejkalon kapacitetin e lejuar prej 2 MW të aprovuar nga MIE”.*
- Në nenin 3 të kontratës nr. 3110 rep., nr. 1429 kol., datë 18.05.2023, është përcaktuar se *në cdo rast, kapaciteti nuk mund të kalojë mbi 2 MW.*
- Për sa më sipër vlerësohet që dhe licenca e prodhimit të energjisë elektrike të jepet për kapacitetin e instaluar 1950 kW.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të Rregullores, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikën 1.2, gërmat “a”, “b” “c” dhe “d”; pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Shoqëria ka depozituar në ERE garancinë e lëshuar nga shoqëria prodhuese e paneleve elektrike, në të cilin është përcaktuar garancia 30-vjeçaree tyre. Në referencë të përcaktimeve të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, afati i licencës për prodhimin e energjisë elektrike do të jetë 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 1950 kW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**